



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:067166  
Datë: 18.07.2022  
Numri i dokumentit: 03238689

C.nr.397/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim Balaj me zyrtaren ligjore Albana Curri, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses A.J. nga Gj., të cilën e përfaqësojnë Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, që të dy avokat në Prishtinë, rruga “Fehmi Agani” Hy – 25/4, kundër të paditurës D.K.A., të cilën e përfaqëson i autorizuari D.B., me autorizim në shkresat e lëndës, për kompensimin e ushqimit gjatë punës dhe shpenzimeve të udhëtimit, vlera e kontestit 1.160,50 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik, në të cilin prezantuan të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, me 14 korrik 2022 mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.J. nga Gj. dhe DETYROHET e paditura D.K.A., që paditëses në emër të kompensimit të ushqimit – shujtave për ditët e pranisë në punë, respektivisht për 337 ditë pune, për periudhën kohore 14.09.2020 – 19.05.2021, të ia paguajë shumën prej 674,00 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër euro), si dhe për shpenzimet e udhëtimit në punë për 695 ditë, për periudhën kohore 02.04.2018 – 19.05.2022, të ia paguajë shumën prej 486,50 (katërqind e tetëdhjetë e gjashtë euro e pesëdhjetë cent), përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1.160,50 (një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë euro e pesëdhjetë cent), me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 02.04.2021 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 259,20 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë euro e njëzetë cent), në afatin prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësja në padinë e parashtruar në këtë gjykatë me datë 02.04.2021 përmes të autorizuarve të saj si dhe në parashtrësën lidhur me precizimin e kërkesëpadisë, të datës 09.06.2022, ka parashtruar se e njëjta është e punësuar tek e paditura, përkatësisht në SHFMU “A.” në Gj. Ka shtuar se sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, konkretisht kapitulli IV që ka të bëjë me Rregullat e Përgjithshme dhe Pagat, neni 35 paragrafi 7, thekson se: “Të punësuarve

*u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është dy (2) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”.* Po ashtu paragrafi 5 i nenit të lartcekur iu njeht të drejtën e kompensimit punonjësve arsimor në raport me çmimin e biletës së udhëtimit. E paditura edhe përkundër detyrimeve të cilat rrjedhin nga Kontrata e lartpërmendur, nuk ka përmbushur obligimet e saja, për një kompensim të këtillë, për çka paditësja bazuar në legjislacionin aktual në fuqi i është drejtuar kësaj gjykate për të kërkuar realizimin e të drejtës së saj.

I autorizuari e paditësës gjatë shqyrtimeve në këtë çështje kontestimore si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbeten pranë padisë - kërkesëpadisë dhe precizimit të dorëzuar në këtë gjykatë me datë 09.06.2022, duke i propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e precizuar e paditësës të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe atë me kamatë ligjore prej 8% nga parashtrimi i padisë, e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet procedurale, i kanë kërkuar dhe atë: shumën prej 20,00 euro, e cila i referohet taksës gjyqësore të paguar për padi, shumën prej 104,00 euro, e cila shumë i referohet përpilimit të padisë, shumën prej 135,20 euro, shumë kjo e cila i referohet një seance gjyqësore 104,00 euro shumë kjo e cila i referohet parashtresës së datës 09.06.2022, përkatësisht shumën e përgjithshme 363,20 euro.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadinë e paditësës për shkak se KKA në Kosovë e nënshkruar në mes të MASHT, e datës 22.01.2021, me nenin 47 e ka shfuqizuar KKA të datës 18.04.2017, e po ashtu me sipas nenit 45 të kësaj kontrate nuk janë krijuar mundësitë financiare nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe as që është bërë ndonjë planifikim për Komunitat në nivel të Republikës. Ka deklaruar se nuk e kundërshton precizimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv (zmadhimin e kërkesëpadisë). Me propozim për gjykatës që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pa bazuar

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Vërtetim të lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë, pa datë të lëshimit, për relacionin Gjakovë – Dol, Certifikatën e vendbanimit me nr. ser B 10308637 – të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile – Gjakovë, me datë 23.02.2021, Vërtetim për ditët e prezencës në punë, nr.1014, datë 23.05.2022, i lëshuar nga SHFMU “Anton Qeta” Dol, Komuna Gjakovë, Vërtetim për ditët e prezencës në punë nr. 1013/22, datë 23.05.2022, i lëshuar nga SHFMU “A.” D., Komuna Gjakovë dhe Kontratën e punës, me nr. prot. 530, datë 01.09.2016, e lidhur në mes të paditësës dhe të paditurës.

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, e mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se kërkesëpadia e paditësës është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë, pa datë të lëshimit, për relacionin Gjakovë – Dol, vërtetohet se çmimi i biletës në relacionin Gjakovë – Dol, në një drejtim kushton 0,50 euro.

Nga certifikata e vendbanimit me nr. ser B 10308637 – të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile – Gjakovë, me datë 23.02.2021, vërtetohet se këtu paditësja A.J., vendbanimin e ka në Gj., në rrugën... nr. 27/2.

Nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë, nr.1014, datë 23.05.2022, i lëshuar nga SHFMU “A.” D., Komuna Gjakovë, vërtetohet se paditësja në institucionin e lartpërmendur në periudhën kohore nga data 14.09.2020, e deri me datë 19.05.2022, ka vijuar 337 ditë pune.

Nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë, nr.1013, datë 23.05.2022, i lëshuar nga SHFMU “A.” D., Komuna Gjakovë, vërtetohet se paditësja në institucionin e lartpërmendur në periudhën kohore nga data 02.04.2018, e deri me datë 19.05.2022, ka vijuar 695 ditë pune.

Nga kontrata e punës, me nr. prot. 530, datë 01.09.2016, vërtetohet se paditësja në cilësinë e mësimdhënëses, ka punuar në shkollën “A.” – D. dhe kohëzgjatja e kontratës së punës është 01.09.2016 – e përhershme.

Gjykata pas administrimit të provave të lartcekura, në raport me kërkesën e paditëses e cila ka të bëjë me kompensimin e shujtës ditore, duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, datë 18.04.2017 si dhe kontratën e datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t’a bërë kompensimin”* dhe duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk ka argumentuar faktin se e ka të rregulluar çështjen e ushqimit të të punësuarve (në vendpunimin – objektin ku ka punuar këtu paditësja), erdhi në përfundim se kërkesa e paditëses për këtë kompensim (shujtë ditore) është e themeltë, duke ia njohur të njëjtës shumën prej 674,00 euro, duke e bërë përllogaritjen si në vijim ( $337 \times 2 = 674,00$ ).

Lidhur me kërkesën e dytë të paditëses e cila ka të bëjë me shpenzimet e udhëtimit në punë, gjykata vendosi duke u bazuar në dispozitën e nenit 35 paragrafi 5, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse – ku punojnë, i paguhet shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*. Andaj bazuar në dispozitën e lartcekur, si dhe në provat e administruara, erdhi në përfundim se kërkesa e paditëses për këtë kompensim është e themeltë, duke ia njohur të njëjtës shumën prej 486,50 euro, duke e bërë përllogaritjen si në vijim ( $695 \times 0,70 = 486,50$ ).

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: “*Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij*”. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditëses në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë së precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor sipas nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, me ç’rast paditëses iu pranua shuma e përgjithshme prej 259,20 e cila shumë i referohet: taksës gjyqësore për padi shuma prej 20,00 euro, për përpilimin e padisë shuma prej 104,00 euro, dhe për përfaqësimin e të autorizuarve të paditëses në shqyrtimin kryesor shumë prej 135,20 euro, ndërsa nuk ia pranojë shumë tjetër të kërkuar prej 104,00 euro, e cila shumë i referohet përpilimit të parashtresës së datës 09.06.2022, meqë përmbajtjen e të njëjtës, të autorizuarit e paditëses kanë mundur që të e paraqesin në shqyrtim.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.397/21, me 14 korrik 2022

GJYQTARI,  
Durim Balaj

### UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.